

VENDIM
Nr. 386, datë 29.6.2023

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 392, DATË 30.6.2021, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E SPECIALITETEVE NË FORCAT E
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1/1, të nenit 21, të ligjit nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shtojcën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 392, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e specialiteteve në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

a) Kudo në rreshtin 2, pas emërimit “... Orkestra Frymore e FA-së ...” shtohet “ ... Orkestra Simfonike e FA-së ...” dhe pas fjalëve “... në bandën frymore të FA-së ...” shtohen “... ose në Orkestrën Simfonike të FA-së ...”;

b) Pas rreshtit 4 shtohen rreshtat 5 dhe 6, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

5	Jurist	“Jurist” – oficeri, i cili ka përfunduar studimet në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë ose arsimin juridik të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të ligjit përkatës për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë, dhe ushtron detyrën e tij në një pozicion me specialitet të përcaktuar në TOP, si “jurist/këshilltar ligjor”, prej një periudhë jo më pak se 2 (dy) vitesh.
6	Kimist/biolog/fizikant	“Kimist/biolog/fizikant” – oficeri/nënoficeri, i cili ka përfunduar studimet e larta ose shkollë tjetër të profilit të shkencave të natyrës, brenda dhe jashtë vendit, ose ka kryer kurset e nevojshme përkatëse dhe ushtron detyrën e tij në një funksion organik në strukturën e FA-së, si pjesë e shërbimit të MADM-së, në përputhje me formimin (diplomën, kursin) e fituar.